

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6893  
E enjte, 12 maj 2023  
Çmimi 0.40 €

Çdo ditë e më shumë  
po qartësohet procesi  
i ndërtimit të  
Asociacionit **FAQE 7**

Shkruan:  
Avni ARIFI



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

I DËRGUARI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN ME SERBINË,  
MIROSLAV LAJÇAK, KA TAKUAR TË ENJTEN KRYEMINISTRIN ALBIN KURTI  
DHE KA VIZITUAR VERIUN **FAQE 3**

## LAJÇAKU KA VETËM NJË PRITJE: TË GJEJMË NJË MARRËVESHJE QË NUK DO TË ÇOJË NË PËRSHKALLËZIM



I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun me Serbinë, Mirosllav Lajçak, ka ardhur të enjten për vizitë në Prishtinë. Ai ka zhvilluar një takim me kryeministrin Albin Kurti, me të cilin ka biseduar për ecjen e

mëtutjeshme të dialogut. Pas takimit me Kurtin, Lajçaku ka theksuar se shpresa e tij është se do të ketë një zgjidhje politike e që duhet të fokusohemi në zbatimin e marrëveshjes së arritur në Ohër dhe mos të çojë në

përshkallëzim. E kryeministri Kurti ka theksuar nevojën që marrëveshja bazë të zbatohet në tërësi dhe nevojën që BE-ja ta mbajë Serbinë përgjegjëse për shkeljet e vazhdueshme të kësaj marrëveshjeje

### OPINION

**BASHKIMI UÇK - LKÇK I 11 MAJIT 1998, MESAZH UNITETI E FUQIZIMI I LUFTËS SONË ÇLIRIMTARE **F. 7****

Shkruan:  
Valon MURATI



### AKTUALE



**MILIONA NJERËZ JANË ZHVENDOSUR NGA LUFTËRAT DHE FATKEQËSITË NATYRORE NË MBARË BOTËN **F. 2****

**HAMZA PAS TAKIMIT ME LAJÇAKUN: KAM PIKËPYETJET E MIA LIDHUR ME DRAFTIN PËR ASOCIACIONIN **F. 3****

### EKONOMI



**NDËRTOHET IMPIANT URBAN I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA PËR 30 000 BANORË TË GJAKOVËS **F. 8****

KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ) ADRESON AKUZA NË DREJTIM TË ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR NË HAGË

## KMDLNJ-ja: ZPS-ja PO I FSHEH PROVAT SHFAJËSUESE PËR TË AKUZUARIT DHE PO KURDIS DËSHMITARË TË RREMË TË TRAJNUAR NGA UDB-a **FAQE 4-5**



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Ministrat e Financave të G7-s zotohen ta mbështetin Ukrainën

**TOKIO, 11 MAJ** - Udhëheqësit financiarë të Grupit të Shtatë ekonomive të përparuara (G7) po diskutojnë për mënyrat për ta mbështetur Ukrainën dhe për t'i bërë presion Rusisë për t'i dhënë fund luftës. Ata të enjten janë mbledhur në një samit në Japoni. Ministri i Financave i Ukrainës, Serhiy Marchenko, ishte pjesëmarrës në këtë takim përmes një video-lidhjeje në sesionin e parë të bisedimeve të G7-s në qytetin bregdetar Niigata. Sekretarja e Thesarit e ShBA-së, Janet Yellen, tha se vendet e G7-s "do të qëndrojnë me Ukrainën për aq kohë sa duhet" për t'i dhënë fund luftës.

Udhëheqësit do të shqyrtojnë mënyra për ta parandaluar Rusinë dhe vendet e tjera që t'i anashkalojnë sanksionet kundër Moskës për pushtimin e saj, u tha gazetarëve ministri japonez i financave, Shunichi Suzuki. Lufta dhe pasojat e saj në ekonominë globale, krizat e borxhit në vendet në zhvillim dhe ngërçi në Uashington mbi borxhin kombëtar, janë në krye të agjendës së tri ditëve të bisedimeve nga ministrat e



Financave dhe guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të G7-s.

Një gamë e gjerë temash, që nga ndryshmet klimatike e deri te lehtësimi i borxhit, pritet të shqyrtohen në këtë takim.

Duke folur përpara se të fillonin takimet me dyer të mbyllura, Yellen tha se një nga prioritetet e saj ishte ta theksonte rëndësinë e

zgjdhjes së krizës.

Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, tha të mërkurën se ai dhe udhëheqësit e Kongresit patën një takim "produktiv" të martën në përpjekje për ta rritur kufirin e borxhit të vendit.

Bideni tha se është "absolutisht i sigurt" se vendi mund të shmangte një falimentim. Yellen tha se ka "shumë shpresë" se

problemi mund të zgjidhet me kohë.

Yellen gjatë këtij samiti do të përpiqet t'i qetësojë homologët e saj për dështimet e fundit të bankave në ShBA që kanë ngritur shqetësimet mbi rreziqet për sistemin financiar global. Ajo tha se investimet "historike" të Bidenit në modernizimin e infrastrukturës amerikane ishin

një hap drejt përmirësimit të qëndrueshmërisë së një ekonomie, e cila u luhat shumë gjatë pandemisë së Covid-19.

Edhe ekonomitë e tjera të G7-s po luftojnë me inflacion, duke i detyruar bankat e tyre qendrore t'i rritin normat e interesit.

Udhëheqësit financiarë të G7-s u takuan vetëm një muaj më parë në Uashington gjatë takimit vjetor të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Atje ata përsëritën angazhimin e tyre për t'i ndihmuar ekonomitë të përballen me ndikimin e luftës në Ukrainë, për t'i ndihmuar vendet me borxhe të mëdha ta zgjidhin cenueshmërinë e tyre financiare, t'i forcojnë sistemet globale shëndetësore dhe të ndihmojnë në trajtimin e ndryshimeve klimatike.

G7 përbëhet nga Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Të ftuar të tjerë në takim në Niigata përfshijnë Bashkimin Evropian, FMN-në dhe Bankën Botërore, si dhe ministrat e financave të Brazilit, Indisë, Indonezisë, Koresë së Jugut dhe Singaporit.

## Miliona njerëz janë zhvendosur nga luftërat dhe fatkeqësitë natyrore në mbarë botën



**OSLO, 11 MAJ** - Sipas një raporti të publikuar të enjten nga Qendra e Monitorimit të Zhvendosjes së Brendshme të Këshillit Norvegjez të Refugjatëve, lufta në Ukrainë ka ndikuar që numri i njerëzve të zhvendosur nga konfliktet ose fatkeqësitë natyrore të arrijë një rekord të ri prej 71.1 milionësh vitin e kaluar.

Deri në fund të vitit 2022, 5.9 milionë njerëz ishin detyruar të lëviznin brenda Ukrainës për shkak të pushtimit të Rusisë, duke e çuar totalin global të njerëzve të zhvendosur brenda vendit nga konflikti dhe dhuna në më shumë se 62 milionë, një rritje prej 17 % që nga viti 2021. Siria kishte 6.8 milionë të

zhvendosur nga konflikti pas më shumë se një dekade lufte civile. Numri i njerëzve të zhvendosur brenda vendit të tyre në fund të vitit, për shkak të fatkeqësive si përmbytjet dhe uria, arriti në 8.7 milionë, rreth 45 % më shumë nga viti 2021.

Zhvendosja e brendshme u referohet njerëzve që detyrohen të lëvizin brenda kufijve të vendit të tyre dhe raporti i Qendrës së Monitorimit të Zhvendosjeve të Brendshme nuk ka marrë parasysh ata që janë larguar në vende të ndryshme.

Agjencia e Kombeve të Bashkuara tha këtë javë se 700 000 njerëz tashmë janë zhvendosur brenda disa javësh

nga konflikti në Sudan.

Qendra e Monitorimit të Zhvendosjeve të Brendshme përmendi ciklin natyror të motit La Nina, i cili vazhdoi për të tretin vit radhazi në vitin 2022, si një faktor kryesor në zhvendosjet nga fatkeqësitë.

Ai kontribuoi në nivelet rekord të zhvendosjes së përmbytjeve në Pakistan, Nigeri dhe Brazil dhe në thatësinë më të keqe të regjistruar në Somali, Keni dhe Etiopi, thuhet në raport. "Kishte një stuhë konfliktesh dhe fatkeqësish natyrore në vitin 2022, duke çuar në zhvendosje në një shkallë të paparë më herët", tha Jan Egeland, sekretar i përgjithshëm i Këshillit Norvegjez të Refugjatëve.

## Presidenti Biden, trysni republikanëve për kufirin e borxhit

**UASHINGTON, 11 MAJ** - Presidenti Joe Biden kritikoi ashpër shkurtimin e shpenzimeve që kërkojnë republikanët duke paralajmëruar se ai do të kishte pasojat të rënda, në një fjalim me stil fushate para votuesve në Valhalla të shtetit të Nju-Jorkut. Ai i bëri komentet derisa ligjvënësit diskutonin në Uashington për

rritjen e kufirit të borxhit qeveritar.

Presidenti Biden po e trajton gjithnjë e më shpesh temën e kufizimeve të mundshme të buxhetit, megjithatë ai këmbënguli përsëri se çdo diskutim i tillë duhet të bëhet pa shtuar rrezikun që qeveria federale të mos jetë në gjendje t'i paguajë shpenzimet e saj.

Derisa ai mbante fjalimin, negociatorët nga Shtëpia e Bardhë dhe Kongresi u takuan për dy orë privatisht në Kapitol për të diskutuar për hapat e mëtejshëm. "Amerika është ekonomia më e fortë në botë, por ne duhet t'i shkurtojmë shpenzimet dhe ta ulim deficitin pa shkaktuar një krizë të panevojshme", tha Bideni.



I DËRGUARI I POSAÇËM I BASHKIMIT EVROPIAN PËR DIALOGUN ME SERBINË, MIROSLAV LAJÇAK, KA TAKUAR TË ENJTEN KRYEMINISTRIN ALBIN KURTI DHE KA VIZITUAR VERIUN

# Lajçaku ka vetëm një pritje: Të gjejmë një marrëveshje që nuk do të çojë në përshkallëzim

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun me Serbinë, Miroslav Lajçak, ka ardhur të enjten për vizitë në Prishtinë. Ai ka zhvilluar një takim me kryeministrin Albin Kurti, me të cilin ka biseduar për ecjen e mëtutjeshme të dialogut. Pas takimit me Kurtin, Lajçaku ka theksuar se shpresa e tij është se do të ketë një zgjidhje politike e që duhet të fokusohemi në zbatimin e marrëveshjes së arritur në Ohër dhe mos të çojë në përshkallëzim. E kryeministri Kurti ka theksuar nevojën që marrëveshja bazë të zbatohet në tërësi dhe nevojën që BE-ja ta mbajë Serbinë përgjegjëse për shkeljet e vazhdueshme të kësaj marrëveshjeje

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 11 MAJ** - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun me Serbinë, Miroslav Lajçak, ka takuar të enjten në Prishtinë kryeministrin Albin Kurti. Pas takimit me Kurtin, Lajçaku ka folur për medie, duke theksuar se me Kurtin pati një diskutim të rëndësishëm sa i përket ecurisë së dialogut. "Erdba në Prishtinë sot për të diskutuar me kryeministrin Kurti dhe zëvendëskryeministrin [Besnik] Bislimi për rrugën përpara në procesin e normalizimit pas takimit të 2 majit. Është e rëndësishme që e kuptojmë qartë sekuencën e hapave (që do të ndërmerren), kështu që patëm një diskutim të rëndësishëm në të gjitha aspektet. Unë do të kem të njëjtat diskutime nesër në Beograd", ka thënë Lajçaku. Emisari evropian ka thënë se qëllimi i takimit ishte të krijohet një kuptim i qartë se si do të veprohet tani e tutje. "Ne kemi marrëveshjen, kemi aneksin, ndaj duhet të kemi një kuptim të qartë të hapit të parë, hapit të dytë dhe hapit të tretë", u shpreh ai, duke shtuar se diskutimi me kryeministrin e Kosovës ishte "shumë intensiv, por shumë i rëndësishëm". "Me të vërtetë shpresoj se do të ketë një zgjidhje politike që do të na lejojë të gjithëve të fokusohemi në normalizimin dhe zbatimin e marrëveshjes", u shpreh ai.

I pyetur për modelin kroat për Asociacionin, për të cilin Qeveria e Kosovës insiston, Lajçaku u shpreh se ajo që është e pranueshme për Bashkimin Evropian është diçka që "bazohet në normat evropiane dhe vlerat evropiane, e cila është në përputhje me modelet ekzistuese evropiane". "E kemi thënë që në fillim. Nuk do të them më shumë për këtë. Unë mendoj se jam mjaft i qartë", u shpreh ai. Lajçaku bëri me dije se do të takohet me kryenegociatorët e dy shteteve në dialog, përkatësisht me Besnik Bislimin dhe Petar Petkoviçin të hënën e 15 majit. Ndërsa kryeministri Kurti në "Twitter" tha se në takim me Lajçakun ka nënvizuar rëndësinë e zbatimit të marrëveshjes bazë të arritur në Ohër me Serbinë. "Theksova nevojën që marrëveshja bazë të zbatohet në tërësi dhe nevojën që BE-ja ta mbajë Serbinë përgjegjëse për shkeljet e vazhdueshme të kësaj marrëveshjeje", ka shkruar Kurti. Emisari evropian, pas vizitës në Kosovë, pritet të shkojë edhe në Serbi.

## Çfarë tha Lajçaku në veri?

Gjatë vizitës së tij në Mitrovicë e Veriut, Miroslav Lajçak u pyet në lidhje me çështjen e hapjes për qarkullim të urës mbi lumin Ibër, mes Mitrovicës së Jugut dhe asaj të Veriut. Hapja e kësaj ure u diskutua ditë më parë me iniciativën e disa



asamblistëve të komunës së Mitrovicës së Veriut. "Është në duart e dy palëve. Ato duhet të pajtohen. Ne duam që hapja e urës të kontribuojë në një stabilitet më të madh sesa në destabilizim. Prandaj, insistoj që duhet ta përdorim platformën e dialogut për t'u pajtuar për një rrugë përpara", ka pohuar Lajçaku. Lajçaku tha se qëllimi i vizitës së tij në veri është që të marrë "informacionin e dorës së parë nga njerëzit që jetojnë këtu për të parë se si e shohin situatën ata". Ai tha se ka dëgjuar për shumë çështje që komuniteti atje i sheh si problematike, pa treguar se cilat janë ato. Ndërkaq, i pyetur se cilat janë pritjet e tij dhe kur pritet që kryetarët e zgjedhur në komunat veriore të Kosovës të fillojnë t'i ushtrojnë detyrat e tyre, ai tha se pritja e vetme e tij është që "do ta gjejmë një zgjidhje që nuk do të çojë në eskalim". "Unë kam vetëm një pritje që të do të gjejmë një marrëveshje që nuk do të çojë në përshkallëzim. Kjo është pritshmëria ime. Kjo do të thotë që ka përfaqësues politikë që kanë autoritetin dhe ne po flasim me ta dhe presim që ata të gjejnë një zgjidhje. Kjo është ajo për të cilën po diskutojmë", ka thënë Lajçaku.

## KDI: Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të jetë baza për hartimin e statutit të Asociacionit

Instituti Demokratik i Kosovës ka theksuar se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë baza për hartimin e statutit të Asociacionit. Sipas KDI-së, që nga arritja e marrëveshjes mbi rrugën drejt normalizimit të marrëdhënies në mes të Kosovës dhe Serbisë, në takimin e mbajtur në Ohër më 18 mars të këtij viti, procesi i dialogut është futur në një periudhë dinamike të zhvillimeve dhe angazhimit të palëve. "Instituti Demokratik i Kosovës e vlerëson tejet të rëndësishëm gatishmërinë e palëve për të lëvizur përpara drejt normalizimit të marrëdhënies pas dakordimit për Deklaratën për të pagjeturit dhe zbatimin e marrëveshjes lidhur me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Duke qenë se, një prej çështjeve më akute që derivojnë nga dialogu është statuti i Asociacionit, KDI e konsideron të papranueshëm

çdo model të prezantuar në dialog që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe që është në shpërputhje me udhëzimet e Aktgjyqimit përkatës të Gjykatës Kushtetuese", thuhet në komunikatën e KDI-së. KDI-ja ka rikujtuar që Kosova në vazhdimësi ka marrë garanci nga faktorët ndërkombëtarë, në veçanti nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që Asociacioni do të jetë në pajtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës. "Pas propozimeve mbi draft-statutin dhe diskutimeve mbi rregullimet alternative të Asociacionit, i rikujtojmë Qeverisë së Kosovës që të gjitha veprimet për themelimin e Asociacionit duhet të kenë për bazë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe zbatimin e parimit të kushtetutshmërisë", është thënë në komunikatën e KDI-së.

## Hamza pas takimit me Lajçakun: Kam pikëpyetjet e mia lidhur me draftin për Asociacionin

**MITROVICË, 11 MAJ** - Kryetari i Mitrovicës, Bedri Hamza, ka takuar të enjten emisarin e Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, me të cilin ka biseduar për situatën e përgjithshme në Kosovë. Ai ka thënë se folën edhe për çështjen e dialogut, për zhvillimet që janë duke ndodhur në Kosovë, posaçërisht në veri.

Hamza tregoi se me Lajçakun kanë diskutuar edhe për çështjen e rihapjes së Urës së



Ibrit si dhe për përparimin e arritur përgjatë viteve. "Gjithsesi se ka qenë temë

çështja e Urës së Ibrit dhe nevoja që të respektohet dhe zbatohet Kushtetuta e të gjitha

ligjet në fuqi që garantojnë lirinë e të gjithë qytetarëve, mallrave dhe gjithçka tjetër. Kemi biseduar edhe për progresin e arritur gjatë këtyre viteve, por edhe për ndjeshmërinë që ndodhet në këtë pjesë dhe është prezent në këtë pjesë të Kosovës", ka thënë ai. Sipas tij, duhen veprime që të krijohen kushte që të ketë liri për lëvizjen e qytetarëve pa pengesa dhe të mallrave.

Hamza foli edhe për draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe,

që është prezantuar në takimin e 2 majit në Bruksel nga kryeministri Albin Kurti. "Tash është prezantuar një draft-statut, i cili, sipas të gjitha gjasave, është një dokument që është diskutuar, por jo diçka më shumë. Ka opsione të ndryshme dhe sigurisht që këto çështje kanë për t'u definuar në ditët e ardhshme. Pra është prezantuar një dokument. Se a ka qenë rruga për të shkuar deri aty, unë i kam pikëpyetjet e mia", ka thënë Hamza.



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ) ADRESON AKUZA NË DREJTIM TË ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR NË HAGË

## KMDLNj-ja: ZPS-ja po i fsheh provat shfajësuese për të akuzuarit dhe po kurdis dëshmitarë të rremë të trajnuar nga UDB-a

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), në një reagim me titull “Prokuroria Speciale në Hagë po përpiket të pamundësorë mbrojtjen e të akuzuarve”, ka akuzuar Zyrën e Prokurorit (ZPS) në Hagë se në mënyra të ndryshme është duke bërë përpjekje ta pengojë mbrojtjen e liderëve të UÇK-së. Po ashtu, ky këshill e ka akuzuar ZPS-në se është duke tentuar ta frikësojë mbrojtjen e Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit. Sipas këtij këshilli, kjo përpjekje e ZPS-së paraqet shkelje flagrante të të drejtave të njeriut. KMDLNj-ja e ka akuzuar ZPS-në edhe për fshehjen e deklaratave shfajësuese ndaj liderëve të UÇK-së dhe kurdisje të dëshmitarëve të rremë e të trajnuar nga UDB-a serbe

**EPOKA ERE**

**Lirim GECI**

**PRISHTINË, 10 MAJ** - Në Gjykatën Speciale në Hagë është duke u zhvilluar procesi gjyqësor ndaj katër drejtuesve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Seancat në të cilat janë duke u dëgjuar dëshmitarët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë të mbyllura për publikun.

Për fillimin e këtij procesi dhe zhvillimet rreth tij, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka adresuar një mori akuzash kundër ZPS-së në Hagë.

Ky këshill e ka akuzuar ZPS-në se është duke u angazhuar në

vazhdimësi ta pengojë mbrojtjen e Thaçit, Veselit, Selimit, Krasniqit dhe të tjerëve. “Që nga fillimi të akuzuarit nuk i kanë marrë materialet ose i kanë marrë vetëm pjesërisht të përkthyer në gjuhën shqipe apo gjuhën që e kuptojnë që është e drejtë elementare e njeriut dhe ‘conditio sine qua non’ për përgatitje të një mbrojtjeje efektive që i garantohet me të gjitha ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare për persona të privuar nga liria”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Në këtë kontekst, KMDLNj thotë se po të ishte Gjykata Speciale dhe ZPS-ja pjesë e sistemit të drejtësisë të Kosovës detyrimisht do të duhej të përktheheshin të gjitha materialet në gjuhën shqipe që, sipas Kushtetutës së Kosovës, është

gjuhë zyrtare. “Së fundi, prokurori i Zyrës së Specializuar ka deklaruar se nuk kanë asnjë detyrim ligjor t’i përkthejnë materialet në gjuhën shqipe duke iu referuar rastit të Jakup Krasniqit. Ishte skandaloze që edhe vendimi për caktim të paraburgimit dhe konfirmimi i aktakuzës, vetëm pjesërisht ishin të përkthyer në gjuhën shqipe dhe arsyeimi i Dhomave të Specializuara (DhS) ishte se: ‘materialet po përkthehen...’. Kjo është, sipas KMDLNj-së, shkelje flagrante e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria që drejtpërsëdrejti ndikon në cilësinë e përgatitjes së një mbrojtjeje efektive aq më parë që shumica e të akuzuarve nuk kanë njohuri të mjaftueshme që mbrojtjen ta përgatitin në gjuhën që e imponon

Gjykata Speciale’, është thënë në këtë reagim.

Më tutje, KMDLNj e ka akuzuar ZPS-në se është duke u përpjekur ta frikësojë edhe mbrojtjen e liderëve të UÇK-së. “Për të bërë edhe më shumë presion në pamundësimin e mbrojtjes të të akuzuarve, Prokuroria Speciale në Hagë po përpiket t’i frikësojë mbrojtësit duke kërkuar nga trupi gjyqësor t’i sanksionojë avokatët për opinionet e tyre publike në media të ndryshme në kohën kur pikërisht kjo Prokurori Speciale në mënyrën më brutale e shkel parimin e prezumimit të pafajësisë duke deklaruar, jo vetëm një herë, se të akuzuarit mund të dënohen me burg të përjetshëm, pa një vendim të formës së prerë të gjykatës përkatëse”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Si përpjekje për kërcënim të ZPS-së, KMDLNj ka përmendur edhe rastin e avokatit të ekipit të mbrojtjes të Hashim Thaçit. “Po në të njëjtat valë ishte edhe kryetarja e DhS-së e cila shkeli etikën profesionale dhe betimin e dhënë duke u treguar shumë e anshme ende pa filluar procesi gjyqësor. Prokuroria Speciale asnjëherë nuk u distancua nga këto kërcënime, kurse kryetarja e DHS-së u betua në hirin e nënës së kremuar, betim

ky që nuk zë vend as në të drejtën zakonore apo te fiset e lëre më në një gjykatë që pretendon standardet më të larta të drejtësisë. Prokuroria Speciale në Hagë po i bën presion avokatit të ekipit mbrojtës të presidentit Hashim Thaçi, Dastid Pallaska, duke e akuzuar se me deklaratat e dhëna në RTK, se në Hagë po gjykohej UÇK-ja, po bie ndesh me nenin 13 (a) të Kodit të Sjelljes Profesionale për avokatë dhe, në këtë mënyrë, po e shton klimën e frikësimit dhe ambientit kundër Dhomave të Specializuara, prandaj kërkon sanksionimin e avokatit Pallaska për këtë deklaratë”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së, i cili drejtohet nga Behxhet Shala.

KMDLNj-ja ia ka rikujtuar ZPS-së se në vazhdimësi i ka fshehur provat shfajësuese ndaj liderëve të UÇK-së. “Po e njëjta Prokurori Speciale po ‘harron’ se në vazhdimësi ka fshehur provat shfajësuese për të akuzuarit, ka kurdisur dëshmitarë të rremë dhe të trajnuar nga UDB-a serbe dhe KOS-i (shërbimi kundërinformativ ushtarak serb), ka bërë presion në dëshmitarë, thuaja shumicën e materialeve ‘inkriminuese’ i ka nga Serbia, se nuk ka bërë asnjë hetim apo nuk ka kërkuar zyrtarisht hetim për rrjedhje, kontrabandim

## Bislimi tha se migrimi është diçka normale, Gërzhaliu: Deklaratat e tilla nuk i bëjnë nder Kosovës

PRISHTINË, 11 MAJ - Njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërzhaliu, duke komentuar deklaratën e zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bisilimi, i cili e cilësoi migrimin diçka normale, tha se deklaratat e tilla nuk i bëjnë nder Kosovës.

Gërzhaliu për RTV21 ka thënë se migrimi duhet të analizohet jo vetëm në aspektin ekonomik dhe social, por edhe në atë politik. "Në rend të parë pandemia demografike që po i kanoset Kosovës është shqetësim i madh, në rend të dytë duhet të kuptohet që migrimi në Kosovë nuk mund të krahasohet me migrimin në Gjermani, Austri dhe Zvicër, sepse ato janë shtete të konsoliduara dhe nuk ballafaqohen me një strategji për

shkatërrim të tyre siç ballafaqohet Kosova me një plan të draftuar shumë më herët për zbrazen apo shkatërrimin e Kosovës. Prandaj besoj se deklaratat e tilla nuk i bëjnë nder Kosovës. Duhet të jemi të riorientuar në zhvillim ekonomik. Duhet të jemi të orientuar në avancim të dialogut dhe partneritetit. Duhet të kthehet besimi i humbur se në Kosovë mund të jetohej dhe jo të mbështetet migrimi, që është 'sëmundja' më kancerogjene që po e kaplon Kosovën çdo ditë e më tepër. Po them, nuk duhet migrimi të analizohet vetëm në aspektin ekonomik dhe social, por edhe në aspektin politik", është shprehur Gërzhaliu.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bisilimi, ka thënë se është diçka normale ikja e qetarëve



nga vendi. "Në Kosovë, në Ballkanin Perëndimor ose në Evropën Lindore, në vazhdimësi ka pasur tendenca për migrim. Diku gjysmë milioni mjekë që

operojnë në Bashkimin Evropian nuk janë të lidhur me Bashkimin Evropian. Do të thotë, migrimi është diçka normale, është pjesë e

tendencave të individit dhe familjeve për t'i përmirësuar standardet e jetesës", ka deklaruar zëvendëskryeministri Bisilimi.

## Ministri Krasniqi takoi kryetarët e rinj të katër komunave në veri



PRISHTINË, 11 MAJ - Ministri i Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Elbert Krasniqi, ka pritur të enjten në takim kryetarët e rinj të zgjedhur në komunat Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Gjatë takimit ai i uroi ata për përgjegjësinë dhe detyrën e re. "I shoqëruar nga asistentja ekzekutive e kryeministrit, Arta Berisha, kam pritur në takim kryetarët e rinj të zgjedhur në komunat Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Erdenit, Lulzim, Izmir dhe

Ilirit i kam uruar përgjegjësinë dhe detyrën e re. MAPL-ja do të jetë në koordinim me kryetarët dhe asamblistët e zgjedhur në konstituimin e organeve komunale, brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Zgjedhjet e jashtëzakonshme në veri të vendit janë mbajtur më 23 prill.

Lëvizja Vetëvendosje ka fituar në Mitrovicë të Veriut dhe në Leposaviq, ndërsa në Zveçan dhe Zubin Potok të parët kanë dalë kandidatët e Partisë Demokratike të Kosovës.

apo shitje të materialeve të ndjeshme nga Zyra e saj e që pastaj janë keqpërdorur për dënime drakonike të Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucati", është thënë në këtë reagim.

Se Gjykata Speciale ku pjesë përbërëse është edhe ZPS-ja janë njëetnike dhe nga aspekti i të drejtave të njeriut janë edhe raciste, sipas KMDLNJ-së, është fakt i pakundërshtueshëm. "Se Gjykata Speciale po e dënon UÇK-në është opinion për të cilin askush nuk mund të dënohet pavarësisht pozitës që e ka, prandaj as avokati Pallaska nuk ka përgjegjësi për këtë. Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk mund ta kërkojë zbatimin e etikës profesionale në mënyrë selektive apo sipas parimit: 'Quod licet Jovi, non licet Bovi' (Çka i lejohet Jupiterit - të fortit, nuk i lejohet buallit apo të dobët...). Me një fjalë, Zyra e Prokurorit të Specializuar e konsideron veten Jupiter (Zot), kurse të tjerët i trajton si buaj apo të dobët", është thënë në reagimin e KMDLNJ-së.

Po ashtu, KMDLNJ-ja e ka akuzuar Gjykatën Speciale edhe për mungesë të transparencës. "Gjykata Speciale e mbyllur

hermetikisht për shumë zhvillime brenda saj pamundëson monitorimin e pavarur të kushteve për të burgosurit, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë, e pamundëson raportimin objektiv duke redaktuar skajshmërisht materialet dhe duke mbyllur seancat edhe për dëshmitarë që gjykata i trajton si të mbrojtur e të cilët për çdo ditë thuaja dalin para medieve elektronike në Kosovë. Gjykata Speciale e zënë në kurth që vet e ka ndërtuar për shkak të mungesës së transparencës dhe llogaridhënies, në përpjekje të përmirësimit të imazhit të shtrirë për toke organizon dhe paguan sondazhe të kurdisura në të cilën paraqitet shkalla e lartë e pëlqyshmërisë së opinionit me punën e kësaj Gjykate, sidomos në Kosovë. Në anën tjetër bënë përpjekje që profesionalisht të korruptojë gazetarët që raportojnë për punën e kësaj Gjykate duke organizuar 'punëtori' në Hagë dhe duke ua mbuluar të gjitha shpenzimet. Përpjekje që përmes korruptimit profesional të hapë mundësi për korruptim material përmes ndërimit të raportit klientelist", është thënë në këtë reagim.



Krejt në fund, KMDLNJ e ka akuzuar Gjykatën Speciale dhe ZPS-në se janë duke e keqpërdorur mosgatishmërinë e institucioneve të Kosovës që të interesohen dhe kundërshtojnë shkeljet flagrante të të drejtave të njeriut të shtetasve të tyre e sidomos të deputetëve të Kuvendit të Kosovës që edhe e kanë votuar themelimin e kësaj gjykate. "Bartësit e posteve më të larta shtetërore, me arsyetim se nuk duan të ndërhyjnë në drejtësi, kanë gjetur një alibi të madhe për

ta maskuar mungesën e vullnetshme të potencës për t'u interesuar për fatin e shtetasve të tyre. Përfundimisht turpi bie mbi Kuvendin e Kosovës që ka mbetur peng i ndikimeve politike!", është thënë në reagimin e KMDLNJ-së. Gjykata Speciale është themeluar si rezultat i raportit të Dick Martyt, i cili e kishte akuzuar UÇK-në për trafikim organesh. Këto akuzë kanë dalë të jenë të rreme pasi në aktakuzën kundër liderëve të UÇK-së askund nuk përmendën

pretendimet e dala nga raporti i Dick Martyt. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga fillimi i muajt nëntor të vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar më 3 prill të këtij viti. Në paraqitjet e mëhershme, por edhe me rastin e nisjes së gjykimit, ata janë deklaruar të pafajshëm. Përpos tyre, në Hagë janë edhe Sali Mustafa, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe Pjetër Shala.

## Pesë shkolla të reja do të ndërtohen në kryeqytet

PRISHTINË, 11 MAJ - Përparim Rama ka bërë me dije se komuna e Prishtinës, së bashku me organizatën IFC, kanë

nënshkruar marrëveshje për nisjen e ndërtimit të pesë shkollave të reja. Këto pesë shkolla të reja do të ndërtohen në Arbëri, Mati

1, Veternik, Kalabri dhe në Qendër. “Brenda periudhës dyvjeçare bashkë me IFC-në do të ndërtojmë gjithsej tetë

shkolla. Pra do të ketë arsim cilësor, kushte më të mira për arsimtarë dhe nxënës”, ka thënë kryetari Rama.



## UNDP-ja me partnerë kremtuan përparimin e arritur në fushën e veprimit për klimën në Prizren dhe Suharekë

PRIZREN, 11 MAJ - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë së bashku me njësinë operative të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC) në Kosovë dhe komunat partnere - Prizrenin dhe Suharekën - kremtuan përparimin e arritur përmes projektit “Forcimi i veprimit lokal të klimës” (SLCA). Kjo ngjarje, e mbajtur në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren, mbledhi një numër të palëve të interesuara ndërkombëtare dhe kosovare, partnerë, përfaqësues të komunave të tjera dhe përfitues, mes tyre folësit kryesorë Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, Arsim Aziri, menaxher i programit të ADC në Kosovë, Shaqir Totaj, kryetar i komunës së Prizrenit dhe Bali Muharremaj, kryetar i komunës së Suharekës.

Ngjarja ofroi një përvojë unike dhe gjithëpërfshirëse duke paraqitur rezultatet, hulumtimet, raportet dhe planet komunale të zhvilluara me mbështetjen e projektit SLCA. Me këtë rast u lansuan disa publikime për ta promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në komunat partnere, duke përfshirë studimet për ndryshimet klimatike dhe planet e ndërhyrjes, si dhe raporte mbi inventarin e GS (gazrave serrë) dhe sistemet e qëndrueshme të ushqimit. Këto botime synojnë të mbështetnin një zhvillim më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm në komunat. Ngjarja ofroi gjithashtu një platformë për diskutim interaktiv, mundësi për rritje dhe ide se si të vendoset baza për mbështetjen e planifikimit dhe zhvillimit strategjik në nivel qendror dhe shkallëzimit të mundësive të zbatimit në komunat e tjera.



## Në Gjilan mbahet dëgjimi publik me qytetarët dhe bizneset për Zonën Ekonomike

GJILAN, 11 MAJ - Komuna e Gjilanit ka organizuar dëgjim publik me qytetarët për Zonën Ekonomike. Në këtë tubim kanë marrë pjesë edhe kryetari i komunës, Alban Hyseni, nënkryetarja Leonora Morina-Bunjaku dhe drejtorët komunalë, sikurse edhe përfaqësues të bizneseve, përfaqësues politikë dhe përfaqësues të një biznesi nga Gjermania dhe Zvicra, me potencial të investimit në Gjilan. Kryetari Hyseni tha me këtë rast se komuna e Gjilanit ka një potencial të madh të zhvillimit ekonomik, ka një mërgatë shumë të madhe që është e fuqishme financiarisht dhe që ka shumë dije për zhvillim të komunës sonë. “Bashkë me drejtorin e Kadastrës, por edhe me pjesën tjetër të ekipit, kemi filluar hulumtimin për parcela të



reja që mund të jenë potencialisht të shfrytëzueshme

për Zonën Ekonomike dhe kemi ardhur në përfundimin që një

pjesë e zonës kadastrale të Gjilanit dhe Livoçit të Epërm, në

afërsi të Liqenit të Livoçit, ku i kemi rreth 146 hektarë në parcela të ndara dhe ku të gjitha bashkohen me rrugët e planifikuara ndërmjet parcelave në total prej 148 hektarësh, janë pjesë jashtëzakonisht e mirë dhe e qasshme për zhvillimin e projektit të zonës industriale ose të parkut industrial”, është shprehur kreu i Gjilanit.

Ai tha se një përparësi jashtëzakonisht e madhe e kësaj parcele është qasja në infrastrukturë, me vetëm 3.5 kilometra larg autostradës Gjilan - Prishtinë, 2.4 kilometra nga rruga magjistrale për në Ferizaj dhe 5.7 kilometra nga qendra e qytetit deri te Zona Ekonomike. “Në parim, është një kombinim jashtëzakonisht i mirë i elementëve që i duhen Zonës Ekonomike”, ka thënë Hyseni.

## “Jetimat e Ballkanit” dhe “Behgjet Pacolli” do të ndërtojnë pesë shtëpi në Mitrovicë

MITROVICË, 11 MAJ - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur në vizitë Halil Kastratin me bashkëpunëtorët e tij nga Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” dhe përfaqësuesit e Fondacionit “Behgjet Pacolli”. Kryetari Hamza, i shoqëruar

nga Kastrati, vizituan shtëpitë e prekura nga vërshimet në qytetin e Mitrovicës, me ç’rast Halil Kastrati me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” dhe përfaqësuesit e Fondacionit “Behgjet Pacolli” kanë shprehur gatishmërinë e ndërtimit të pesë shtëpive për banorët e

Mitrovicës të dëmtuar nga vërshimet.

Kryetari Hamza i ka falënderuar humanistin Kastrati, Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” dhe Fondacionin “Behgjet Pacolli” për bashkëpunim dhe për vazhdimin e projekteve të cilat do të fillojnë të realizohen.



## Çdo ditë e më shumë po qartësohet procesi i ndërtimit të Asociacionit



Shkruan: Avni ARIFI,  
ish-ambasador i Kosovës në  
Emiratet e Bashkuara Arabe

Ekipi Menaxhues (lexo Serbia) ka propozuar një draft-statut që e bën AKS-në një minishtet në shtet edhe pse ai është i vetëdijshëm që ai nuk kalon as te BE/ShBA e as te Kosova. Kosova në anën tjetër ka propozuar një

kurrjë prej parimesh në vend se të propozonte një draft-statut qysh në janar.

Strategjia e BE-së po duket se është: "Statuti i Ekipit Menaxhues do të "qethet pak" dhe do të inkorporohen disa "parime" të Albin Kurtit dhe ky është produkti final që do të mbështetet edhe nga BE-ja dhe nga ShBA-ja.

Strategjia e Ekipit Menaxhues nuk ka qenë kurrë aprovimi i statutit të propozuar në formën e propozuar. Strategjia e tyre ka qenë që ai të jetë bazë e bisedimeve të mëtutjeshme dhe në bazë të asaj çka po duket, këtë e kanë arritur me shumë sukses. Statuti i propozuar është i vetmi dokument në shqyrtim dhe e

vërteta e hidhur është se kurrë nuk do të jetë marrëveshje e mirë për Kosovën nëse punohet mbi këtë dokument

Qeveria e Kosovës e relaksuar se marrëveshjen e ASK-së nuk e ka nënshkruar vet, shpëtimin ende e kërkon te ata që e kanë nënshkruar marrëveshjen e Brukselit. Këtu është duke bërë gabimin kardinal sepse drafti i propozuar po e trason rrugën që të kemi një produkt final shumë më të keq se ai i 2013/2015. Ajo:

1) Nuk i ka dhënë korniza kushtetuese grupit menaxherial për hartimin e statutit dhe kjo do të ishte jetike për vlerësimin e dokumentit të propozuar  
2) Nuk e ka hedhë poshtë në

"tërësi" statutin e EM por në kundërshtim me marrëveshjen e Brukselit dhe pas asnjë koordinim me ndërkombëtarët e ka shkarkuar EM të cilin sigurt prapë do ta pranon në tavolinë.

3) Nuk ka prodhuar kurrë statut por vetëm "parime" e në Kosovën e pasluftës ata që flasin për parime është dëshmuar që "sen" s'kanë.

4) Vazhdon me parulla populliste se këtë e pranojmë e këtë se pranojmë thua ti se bota sillet rreth tyre e në fakt përveç elektoratit të tyre asnjë aleat në kauzë nga bota e civilizuar nuk e kanë. Vazhdojnë elektoratit të tyre t'i shpërlajnë trurin se "vetëmenaxhimi" nuk është

zajednicë.

5) Deklarata e Konjufcës është paralajmërim se Kosova është kah luan shumë dobët në negociata, po shkon drejt barikadimit dhe konfrontimit politik me krejt aleatët tanë.

Në vitin 2006 ishte Serbia që kërcënoi Grupin e Kontaktit (ShBA-në, Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Francën, Italinë dhe Rusinë) se do të i bojkotonte bisedimet për statusin e Kosovës dhe përgjigja e GK-së ishte: "Nuk ju obligojmë e as detyrojmë të merrni pjesë në dialog. Nëse nuk merrni pjesë ju, negociatat dhe marrëveshjen do ta bëjmë vetëm me palën kosovare. Zgjidhja juaj".

## Bashkimi UÇK - LKÇK i 11 majit 1998, mesazh uniteti e fuqizimi i luftës sonë çlirimtare



Shkruan: Valon MURATI

Sot 25 vite ka ndodhur një ndër ngjarjet më të rëndësishme për fuqizimin e luftës çlirimtare. Më 11 maj të vitit 1998 UÇK dhe LKÇK kanë arritur marrëveshjen që i tërë potenciali ushtarak i LKÇK-së të vendoset nën komandën e UÇK-së përderisa LKÇK ka mbajtur pavarësinë e saj politike. Për aq sa kjo ngjarje ka luajtur një rol të madh në ngritjen e luftës sonë në një shkallë tjetër, për aq sa ka ndikuar në rritjen e mobilizimit popullor dhe sidomos në dërgimin e mesazhit se përkundër dallimeve shqiptarët mund të bëhen bashkë në funksion të lirisë së Kosovës, për aq kjo ngjarje disi ka mbetur nën hije nga zallamahia që ka kapluar shoqërinë tonë pas luftës çlirimtare si dhe nga interesat ditore meskine politike që jo çdoherë kanë qenë të interesuara për ta vendosur këtë ngjarje në pediastalin që i takon.

Për më tepër ky bashkim ka ndodhur në një hark kohor ku tri figura qendrore të organizimit të luftës sonë Bahri Fazliu - Gzimi (LKÇK), Ilir Konushevci - Mërgimi (UÇK) dhe Agron Rrahmani - Naseri (LKÇK) e që po ashtu kanë luajtur në rol të rëndësishëm e qenësor në këtë bashkim, kanë ra në fushën e nderit. Bahriu i rënë më 7 maj, Iliri më 9 maj dhe Agroni më 12 maj 1998 janë figurat që me tërë punën e rënien e tyre e simbolizojnë këtë bashkim. Për nder të këtyre tre figurave dhe në respekt të këtij bashkimi, guerilja e Prishtinës është emëruar "BIA" me tre shkronjat e para të dëshmorëve. Sigurisht sot kur kujtojmë këtë bashkim, e këto figura, ne kujtojmë edhe shokun tonë Sali Mustafën - Calin, bashkëveprimtarin e Bahriut, Agronit por edhe Ilirit, komandantin e kësaj guerileje i cili padrejtësisht është dënuar në shkallën e parë nga Dhomat e Specializuara dhe po mbahet i burgosur në Hagë.

P.S.

**Dizajn kredit:** Këtë dizajn të tre dëshmorëve që simbolizon marrëveshjen në fjalë me shumë dashuri e ka realizuar shoku i dashur Gurakuq Dobruna që nuk është më në mesin tonë.



## Zgjerohet lista e barnave esenciale në Kosovë

PRISHTINË, 11 MAJ - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije se lista e barnave esenciale në Kosovë është zgjeruar për 70 lloje të reja të barnave. Vitia ka thënë se nga këto produkte do të përfitojnë qytetarët që ballafaqohen me sëmundje të ndryshme kronike. "Janë shtuar diku mbi 70 produkte të reja për trajtimin e sëmundjeve për qytetarët të

cilët vuajnë nga sëmundje kronike dhe për t'i zgjidhur mundësitë e kurimit për ta", ka theksuar Vitia. Ministri Vitia ka treguar se buxheti për listën esenciale të barnave për këtë vit do të jetë 60 milionë euro. Sipas tij, me këtë buxhet përmbushen deri në një masë nevojat shëndetësore të qytetarëve që të kenë tërë kohën barna me kosto sa më të

përbalueshme. "Lista esenciale e barnave është bërë në bazë të kërkesave të klinikave dhe spitaleve në përputhje me buxhetin që e kemi pasur në dispozicion. Buxheti i paraparë sivjet për mbulimin e barnave esenciale është rreth 60 milionë euro, që paraqet një rritje të ndjeshme krahasuar me vitet paraprake", ka deklaruar ministri Vitia.



## RTK-ja mbyll vitin 2022 pa borxhe të reja

**PRISHINË, 11 MAJ** - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, kryesuar nga kryetari Armend Muja, ka mbajtur mbledhjen e radhës, në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Mbledhja vazhdoi me shqyrtimin e raportit të shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-mars 2023 dhe u shqyrtua raporti vjetor

financiar i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2022. Raportin vjetor financiar e prezantoi kryetari i Bordit të RTK-së, Besnik Boletini, sipas të cilit, RTK-ja e ka përmbyllur vitin 2022 pa borxhe të reja. "Viti 2022 është përmbyllur pa borxhe të reja. Fatkeqësisht kemi trashëguar 1.6 milion euro borxhe dhe aktualisht është 1.3 milion. Do të vazhdojmë të kemi shpenzime sa më racionale, por edhe me qëllimin që të investojmë sa më shumë në program", ka thënë Boletini. Pas prezantimit të raportit,

anëtarët e Komisionit shtruan shumë pyetje në lidhje me punën dhe mbarëvajtjen e mediumit publik. Komisioni vendosi që shqyrtimi i raportit vjetor financiar të RTK-së të vazhdojë edhe në mbledhjen e radhës. Për mbledhjen e radhës u shty edhe shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2022 dhe raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2022. Komisioni vazhdoi punën për shqyrtimin e raportit vjetor të



Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2022, të cilin e prezantoi kryetarija e Bordit, Vjosa Gradinaj. Gradinaj tha se OShP-ja po bën punë të mëdha në trajtimin e lëndëve, por ngriti shqetësimet e

saj për mungesë stafi, e cila, sipas saj, po pamundëson efikasitetin në punë. Kryetari Muja propozoi që shqyrtimi i raportit vjetor të OShP-së të vazhdojë në mbledhjen e radhës.

## AAK-ja e thërret Muratin në interpelancë, kërkon që të bëhet rishikimi i buxhetit, duke përfshirë rritjen e pagave në sektorin publik



**PRISHINË, 11 MAJ** - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kërkuar që të ftohet në interpelancë ministri i Financave, Hekuran Murati. Lajmin e ka dhënë shefi i grupit parlamentar i kësaj partie, Besnik Tahiri. Sipas tij, ndërhyrja e qeverisë në strukturën e të hyrave dhe të shpenzimeve buxhetore ka qenë shumë e dëmshme në rrjedhat e zhvillimit në vend, duke i ngritur normat e tatimit në një rreth anë, në anën tjetër duke i bllokuar investimet kapitale. "Vetëm për dy vjet qeverisje janë bllokuar rreth 500 milionë euro të investimeve kapitale, me çka

është dëmtuar ekonomia e vendit për rreth 200 milionë euro si pasojë e inflacionit dhe vonësës së investimeve kapitale", ka treguar Tahiri. Ai ka shtuar se gjendja e rëndë socio-ekonomike në vend, e krijuar nga niveli i lartë i inflacionit, rritja e çmimeve të konsumit, shtrenjtimi i çmimit të energjisë dhe vendimi për rritjen e tatimit në pronë, kanë bërë që qytetarët të përballen me vështirësi të shumta. Sipas Tahirit, rritja e pagave në sektorin publik do të ishte zgjidhje që do të lehtësonte sadopak këtë situatë, pasi kjo është kërkesë e kohës.

"Kjo rritje do të duhej të ndodhte menjëherë me rishikimin buxhetor dhe kjo do të ndikonte në rritjen e konsumit të përgjithshëm, por edhe indirekt në rritjen e pagave në sektorin privat. Nëse ky veprim nuk ndodh menjëherë, Kosova rezikon të zbrazet dhe të mbesë pa shumë profesionistë të zotë", tha ai. Tahiri ka treguar se kërkesa e grupit parlamentar e AAK-së është të silltet sa më parë në Kuvendin e Kosovës rishikimi i buxhetit për vitin 2023 dhe të përfshihet në këtë rishikim rritja e pagave në sektorin publik.

## Ndërtohet impiant urban i trajtimit të ujërave të zeza për 30 000 banorë të Gjakovës



**GJAKOVË, 11 MAJ** - Falë Gjermanisë dhe Zvicrës, si dhe bashkëpunimit të tyre të ngushtë me Qeverinë e Kosovës dhe komunën e Gjakovës, më 11 maj u hap në Gjakovë një impiant i madh urban për trajtimin e ujërave të zeza i cili do t'u shërbejë rreth 30 000 banorëve. Projekti është zbatuar me sukses nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW. Ambasadori gjerman, Jorn Rohde, ka theksuar se tatimpaguesit gjermanë kanë kontribuar me 6 milionë euro për

ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Gjakovë, i cili do ta përmirësojë cilësinë e lumenjve, liqeneve dhe ujërave nëntokësore dhe në këtë mënyrë do ta përmirësojë ndjeshëm shëndetin dhe cilësinë e jetesës së rreth 30 000 qytetarëve të Kosovës. Ndërkaq ambasadori zviceran Thomas Kolly ka thënë se Zvicra vazhdon ta mbështesë sektorin e ujërave në Kosovë. I nisur së bashku me qeverinë gjermane dhe atë të Kosovës, investimi zviceran prej 8 milionë eurosh ka mundësuar ndërtimin e

impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Gjakovë, si dhe zëvendësimin dhe riparimin e rrjetit të kanalizimit, nga i cili do të përfitojnë drejtpërdrejt qytetarët e Gjakovës, njëkohësisht do të kontribuojnë në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore në Kosovë dhe Shqipëri", ka thënë ai. Kostoja totale e projektit arrin 17 milionë euro. Zvicra dhe Gjermania kanë marrë përsipër pjesën më të madhe të investimit, ndërsa pjesa e mbetur prej 3 milionë eurosh financohet nga komuna e Gjakovës.

## Zvicra thotë se mban mbi 8 miliardë rezerva të Bankës Qendrore ruse

**BERN, 11 MAJ** - Një total prej 8.3 miliardë dollarësh rezerva dhe asete të Bankës Qendrore të Rusisë janë të depozituara në shtetin e Zvicrës. Këtë fakt e bëri me dije Ministria e Ekonomisë në Zvicër. Publikimi i këtyre të dhënave pasoi një vendim të mëhershëm që i detyron institucionet financiare të Zvicrës t'i raportojnë këto fonde, ngjashëm siç funksionon në Bashkim Evropian.

Çdo transaksion në lidhje me menaxhimin e këtyre rezervave dhe aseteve është i ndaluar që nga 25 marsi i vitit të kaluar. Përveç aseteve të Bankës Qendrore të Rusisë, Zvicra ka edhe asete të tjera ruse të ngrira në vlerë të rreth 7.5 miliardë frangave zvicerane. Këto u përkasin njerëzve, kompanive ose organizatave që janë nën sanksione ndërkombëtare për shkak të sulmit rus në Ukrainë, sulm ky që nisi në muajin shkurt të vitit

2022. "Diskutimet po vazhdojnë në BE nëse asetet e Bankës Qendrore të Federatës Ruse duhet të përdoren për investime dhe të ardhurat e tyre të përdoren për rindërtimin e Ukrainës", ka njoftuar qeveria zvicerane, raporton agjencia e lajmeve DPA. Përveç BE-së, shumë shtete të tjera, përfshirë ShBA-në, u kanë vënë sanksione zyrtare të ndryshme të Rusisë si dhe afaristëve të lidhur me Kremlinin.





# Marshimi 'Shtigjeve të Lirisë - 'Mërgimi', i ish-luftëtarëve të UÇK-së, nga Viçidoli i Sylejman Berishës deri te 'Plaku' i Shishmanit



Në nderim dhe kujtim të veprimtarisë së komandantit të Logjistikës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Ilir Konushevcit, i vrarë 25 vjet më parë, më 9 maj 1998, në Qafë të Malit të Bajram Currit, së bashku me doktor Hazir Malën, ish-bashkëveprimtarët dhe bashkëluftëtarët e tij kanë organizuar marshimin "Shtigjeve të Lirisë - 'Mërgimi'".

Ky marshim është organizuar nga shtëpia e Sylejman Berishës në Viçidol të Tropojës e cila ishte streha dhe baza e parë e UÇK-së. Kjo shtëpi dha shumë bukë dhe pushim për djemtë e logjistikës së UÇK-së të cilëve u printe Iliri me shokë.

Nga aty marshimi vazhdoi rreth Lugut të Zi, për të arritur te Qafa e



Çobanit e për të mbërritur te shtëpia e cila ishte baza tjetër e logjistikës së UÇK-së, ajo e Xhemë Jakupit - "Plaku" të Shishmanit.

Tashmë është bërë tradicionale ky

marshim i ish-ushtarëve të UÇK-së, që në këtë mënyrë të kujtohet Ilir Konushevcit dhe bashkëluftëtarët e tjerë të vrarë gjatë luftës.

Nën organizimin e Bekim Shytit, Hysen Dreshajt, Gëzim Sejdijajt, Gani Nuhës, Naim Hazirit, Xhevdet Dukës, Emin Hoxhës, Bashkim Lokajt, Sajmir Konushevcit e shumë bashkëluftëtarëve të Zahir Pajazitit, Ilir Konushevcit, Adrian Krasniqit, Gazmend Imerit (Bardheci) etj., ekspedita e ish-luftëtarëve të lirisë, në përbërje prej më shumë se 50 vetave, është nisur ditën e hënës, më 8 maj, rreth orës 10:00 të mëngjesit, nga kulla e Sylejman Berishës për të marrë rrugën e gjatë mbi 20 kilometra.

Në këtë marshim, përpos ish-

luftëtarëve të UÇK-së, të cilët kanë bartur armatim dhe kanë lëvizur që nga viti 1996 deri ka mesi i vitit 1998 nëpër atë korridor, kanë marrë pjesë edhe djem të rinj, prindërit e disa prej tyre që kanë bartur armatim ose të afërmit e tyre që kanë qenë pjesë e UÇK-së, por që sot nuk janë në mesin tonë.

Ndër ta edhe nipi i Ilir Konushevcit, Art, i cili ka lindur pas luftës, por edhe djemtë e Ganiut, Hysenit e

luftës me armatim, duke përshkruar të gjitha ato kilometra për të arritur në cak. Ata kujtonin edhe vendet kur nëpër borë, shi e nëpër dritë të hënës uleshin për të pushuar nga pesha e rëndë e armatimit që bartnin mbi supet, por kujtonin edhe për vuajtjet që përjetonin rrugës së thepisur, duke mbetur edhe të zbatuar, sepse këpucët që kishin mbathur shumicën e herëve nuk ishin




shumë tjerë të cilët ishin të moshave 13 vjeç e tutje.

Gjatë rrugës Hysen Dreshaj (Besniku), së bashku me Gëzimin (Gencin), Dilaverin, Ganiun, Bekimin, Eminin, Xhevdetin, tregonin për rrugëtimin e tyre gjatë

adekuate për të ecur bjeshkëve. Megjithatë, ata thoshin: "qëllimi ishte të dërgonim armatim në Kosovë dhe të mos biem në prita të ushtrisë dhe policisë serbe". Kjo rrugë e gjatë rreth 20 kilometra përshkruhet si rruga e cila





e Dukagjinit, duke dhënë shpresë se ijemi afruar cakut. Gjatë rrugës ushtarët e FSK-së në numër të konsiderueshëm kishin dalë në nderim të marshimit, por dhe për t'i nderuar 14 të rënë më 29 mars 1999.

Nga aty, me një parakalim dhe nderim shtetëror, vazhduan rrugën me ne deri në fshatin Shishman, ku u pritëm nga shumë qytetarë, medie e fshatarë, të cilët kishin dalë për ta nderuar rrugëtimin tonë si dhe për ta nderuar sakrificën e bërë gjatë luftës të Ilirit me shokë, por edhe të familjes së Xhemë Jakupit. Në shtëpinë e "Plakut" të Shishmanit u vendos një pllakë në shenjë falënderimi për strehimin dhe bukën e dhënë Zahir Pajazitit, Ilir Konushevcit e shumë luftëtarëve të tjerë që kishin fatin të kalojnë nëpër këtë rrugë të mundimshme, por krenare për Ushtrinë Çlirimtare



mesazh: "Jam shumë krenar që për aq vite sa kanë qëndruar tek unë djemtë e UÇK-së, të cilët vinin natën nëpër borë e nëpër shi, asnjëherë dhe asnjë nuk është zbuluar dhe kjo më bën krenar për gjithë jetën time".

Pas zbulimit të pllakës në shtëpinë e bacës Xhemë, i zoti i konakut për të gjithë të pranishmit shtroi darkë në oborrin e tij.

Në përmbyllje të aktivitetit kushtuar "shtigjeve të Lirisë- 'Mërgimi'", në shenjë mirënjohjeje për mbështetjen e logjistikës së UÇK-së, janë vendosur pllaka përkujtimore në këto baza të UÇK-së:

Në shtëpinë e Haxhi Babës në Golem,

Në shtëpinë e Agim Krasniqit në Tiranë,

Në shtëpinë e Besnik Krasniqit në Bajram Curr,

caqet serbe, ushtria dhe policia serbe kishin futur kufirin në një rrethim të fortë, duke ua zënë pritrat shumë grupeve të UÇK-së të cilat

UÇK-së, ndër ta vriten 14 ushtarë që ishin duke u kthyer me armatim nga Shqipëria në Kosovë. Pas më shumë se 4 orë ecje, më në



sillnin armatim në Kosovë ose shkonin në Shqipëri për të dërguar të plagosur.

Pas fillimit të bombardimeve, edhe kjo arterie u mbyll nga ushtria serbe, e cila e bëri të pakalueshme për

fund e gjithë ekspedita e ish-luftëtarëve të lirisë arrin në Qafën e Çobanit - aty në kufirin që ndante Kosovën me Shqipërinë.

Nën përkujdesjen, tani gjeneralit të FSK-së, Hysen Dreshaj, aty u ndez



asnjëherë, asnjë ushtar nuk ka rënë në pritë gjatë viteve 1996-1998, sepse ka qenë shumë e mundimshme për të ecur. Qëllimi i Zahirit, pastaj Ilirit, Bardhecit, Besnikut, Gencit, Emnit, Bekimit, Dilaverit, Ganiut, Dukës dhe Astritit, ishte që kjo rrugë të ruhet, sepse ishte arterie e furnizimit për armatim dhe lëvizje më të sigurt. Pasi lufta kishte marrë përmasa të mëdha e gjatë vitit 1999 kishin filluar edhe bombardimet e NATO-s mbi



ushtarët e UÇK-së, me çka edhe vërtetohet se më 29 mars të vitit 1999 bien në pusi mbi 50 ushtarë të

një flakadan me ngjyrat e flamurit kombëtar. Pasi dolëm në territorin e Kosovës, nga larg shiheshin fshatrat



të Kosovës.

Në emër të ish-ushtarëve të asaj kohe, plakun Xhemë Jakupin e falënderuan për bukën e dhënë dhe strehimin e ushtarëve të logjistikës së UÇK-së, gjeneral Naim Haziri, gjeneral Hysen Dreshaj e Gëzim Sejdiqaj. Ndërsa baca Xhemë, pasi i falënderoi të pranishmit, dha këtë

Në kullën e Sylejman Berishës në Priftq-Viçidol

Në shtëpinë e Xhemë jakupit në Shishman.

**(Nga Sadik ZEQRIRI, ish-ushtar i UÇK-së dhe pjesëmarrës në marshimin "Shtigjeve të Lirisë - 'Mërgimi')"**



# Si e dimë se sa e vjetër është Toka?



Toka është krijuar afro 4.54 miliardë vite më parë. Në fillim janë formuar dhe zhdukur disa kontinente, zgjeruar dhe zvogëluar shtresat e mëdha prej akulli, dhe jeta ka evoluar nga organizmat njëqelizore në balenat blu. Por si e dimë moshën e vërtetë Tokës? Analizat nisin nga brendësia e saj.

“Kur je një shkencëtar i Tokës që analizon një shkëmb, në fakt ai nuk është thjesht një shkëmb, por një objekt që bart me vete një histori, të cilën mund të përpiqesh ta deshifrosh”- thotë Beki Flauer, gjeologe në Universitetin e Kolorados.

Kur mineralet formohen nga magma ose llava, ato shpesh përmbajnë gjurmë të materialit radioaktiv, si uraniu. Me kalimin e kohës, këta elementë radioaktivë shpërbëhen, pra emetojnë rrezatim, duke i transformuar përfundimisht në elementë të rinj më të

qëndrueshëm që mbeten të bllokuar brenda mineralit.

Uranium radioaktiv-238, është një formë e zakonshme e uranimit. Atomet e tij do të lëshojnë energji derisa përfundimisht të kthehen në plumb. Ky proces ndodh me një shpejtësi fikse të njohur si ‘gjysmë jetë’, që përputhet me sasinë e kohës që i duhet gjysmës së atomeve për t’u zbërthyer.

Gjysma e jetës së uranium-238 është më shumë se 4 miliardë vjet, që do të thotë se duhen më shumë se 4 miliardë vjet që gjysma e uraniu-238 të bëhet plumb. Kjo e bën atë të përsosur me objekte që janë shumë, shumë të vjetra. Duke e njohur këtë proces, ne mund të llogarisim se sa i vjetër është një shkëmb bazuar në raportin e elementit radioaktiv “prind” dhe elementit të qëndrueshëm “bijë”, një metodë e quajtur datim radiometrik.

Flauers thotë se për këtë përcaktim moshor përdoret zakonisht minerali zirkon, sepse ai përmban një sasi relativisht të madhe uranumi. Datimi përmes plumbit të uranimit, është vetëm një lloj mënyre e datimit radiometrik. Llojet e tjera përdorin elementë të ndryshëm; për shembull, datimi me radiokarbon, një nga metodat më të zakonshme, që përdor një izotop radioaktiv të karbonit, i cili ka një gjysmë jetëgjatësie prej mijëra vjetësh, dhe është i dobishëm për përcaktimin e moshës së lëndës organike.

Duke përdorur këto metoda, gjeologët kanë gjetur minerale në Tokë që datojnë deri në 4.4 miliardë vjet, që do të thotë se planeti ynë është krijuar përafërsisht në atë kohë. Por nëse shkencëtarët thonë se Toka është më shumë se 4.5 miliardë vjet e vjetër, nga erdhën këto rreth 100 milionë vjet shtesë?

Siç u përmend më lart, Toka s’ka ndryshuar shumë gjatë miliarda viteve, veçanërisht përmes proceseve të tilla si tektonika e pllakave, të cilat e zhvendosin koren, që kanë krijuar kontinente të reja nga magma apo që i kanë zhytur nën ujë kontinentet e vjetra.


Ndaj është e vështirë të gjenden shkëmbinjtë që datojnë që nga fillimi i historisë së planetit. Sepse ata mund jenë gërryer apo shkrirë prej kohësh. Por shkencëtarët mund të përdorin datimin radiometrik për të përcaktuar moshën e shkëmbinjeve nga pjesë të tjera të sistemit diellor.

Disa meteorë përmbajnë materiale që janë më shumë se 4.56 miliardë vjet të vjetra. Edhe shkëmbinjtë e marrë nga Hëna dhe Marsi datojnë rreth 4.5 miliardë vjet më parë. Këto data janë shumë afër kohës kur shkencëtarët mendojnë se nisi

të merrte formë sistemi diellor nga reja e gazit dhe pluhurit që rrethonte Diellin e porsakrijuar.

Dhe duke ditur të gjitha këto epoka relative, ne mund të nisim të hartojmë një plan kohor se si filluan të formohen Toka, Hëna, Marsi dhe të gjithë shkëmbinjtë e tjerë të vegjël që notojnë përreth në hapësirën e afërt. Megjithatë, kalimi nga reja e pluhurit primordial në planetin Tokë nuk ndodhi menjëherë, por përkundrazi gjatë miliona viteve, thekson Rebeka Fisher, shkencëtare e Tokës dhe planetarëve në Universitetin e Harvardit.

Kjo do të thotë se kuptimi ynë mbi moshën e Tokës, do të jetë gjithmonë më pak mbi vitin e saktë se kur u formua planeti, dhe më shumë mbi një ndjenjë të përgjithshme të epokës kur filloi të merrte formë planeti ynë. / LiveScience – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Ndeshja e tretë i takon Trepçës

MITROVICË, 11 MAJ - Trepça ka shënuar fitore të madhe, duke mundur Pejën me rezultat 97:90 (19:21, 23:25, 25:27, 30:17), duke kaluar në epërsi 2:1 në "play-off" të finaleve. Mitrovicasit bën përmbyshjen në dhjetë minutat e fundit, ndërsa sfida e radhës zhvillohet të dielën në Pejë. Pas një fillimi të barabartë prej 8:8, ku të gjitha pikët për mysafirët i shënoi Arti Hajdari, "verdhezinjtë" me katër pikë radhazi kishin epërsi prej 8:12, por më pas një seri prej 7:0 e vendasve përmbysi rezultatin në 15:12, ndërsa çereku i parë përfundoi 19:21. Lojë e barabartë u zhvillua edhe në periudhën e dytë, përkatësisht deri në fund të kësaj pjese, ku pejanët me një seri të suksesshme shkuan në pushim me shifrat 42:46. Në periodën e tretë, skuadra pejane kishte epërsinë më të lartë, në nëntë pikë, 53:62, por mitrovicasit sërish nuk u dorëzuan, kurse shifrat pas 30 minutash ishin 67:73. Përmbyshja e madhe dhe vendimtare ndodhi në dhjetë minutat e fundit. "Xehetarët" mobilizohen maksimalisht dhe me ndihmën e madhe të tifozëve rikthejnë epërsinë në të mirë të tyre, duke triumfuar 97:90. Më të



mirët te vendasit ishin Drilon Hajrizi me 28 pikë e shtatë kërcime dhe Mikaile Tmusiq me 24 pikë, katër kërcime e katër asistime,

kurse më të mirët te mysafirët ishin Brad Waldow me 17 pikë e pesë kërcime dhe Devoe Joseph me 21 pikë.

## Roma fiton minimalisht ndaj Leverkusenit, Juve barazon me Sevillan



ROMË, 11 MAJ - Roma ka shënuar fitore ndaj Bayer Leverkusen me rezultat 1-0 në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Ligës së Evropës. Ndeshja nisi me një rast të Bayer Leverkusen kur rrezuan në minutën e shtatë me Florian Wirtz, por pa sukses. Roma tentoi dy herë në pjesën e parë me Roger Ibanez dhe Andrea Belotti, por nuk ishin të

saktë. Edhe pjesa e dytë nisi më mirë për vendasit që në minutën e 63-të që arritën të marrin epërsi me golin e Edoardo Bove. Krejt në fund ka mundur të barazohen shifrat, kur Jeremie Frimpong ishte afër të shënonte. Ndeshja kthyesë e kësaj përballje zhvillohet pas një jave. Ndërsa Juventus ka marrë një barazim zhgënjës brenda në Torino

me shifrat 1-1 ndaj Sevillas. "Bardhezinjtë" hasën vështirësi në pjesën e parë, pasi nuk gjetën dot asnjëherë kuadratin. Ekipi i Mendilibar shfrytëzoi në maksimum një kundërsulm në minutën e 25-të, teksa finalizoi në mënyrë perfekte sulmuesi nga Maroku, En Nesryri. Në pjesën e dytë, "Zonja e Vjetër" u zgjua dhe barazoi në limite me Gattin.

### SHKURT

#### Derbi Gjilani - Drita luhet pa tifozë

Derbi lokal ndërmjet Gjilanit dhe Dritës i cili zhvillohet të dielën do të luhet pa praninë e tifozëve. Kështu ka njoftuar menaxheri i Gjilanit, Drilon Sylejmani. Ai ka thënë se policia e Kosovës nuk ka marrë përgjegjësinë për të ofruar siguri në këtë ndeshje. "U takuam me Policinë e Kosovës dhe ajo nuk ofroi siguri për këtë ndeshje për shkak se stadiumi i qytetit nuk i ofron kushtet elementare për tifozët. Si rrjedhojë, në stadium do të lejohen vetëm personat zyrtarë të dy klubeve", ka thënë Sylejmani për "KosovaPress". Kjo ndeshje është me rëndësi jetike për të dyja skuadrat. Derisa Drita po lufton për titull të kampiones, Gilani po kërkon vendin e tretë që dërgon në garat evropiane.

#### Muriqi: Jam në parajsë, dua të rri këtu deri në fund të karrierës

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, është një prej sulmuesve më të rrezikshëm në La Liga. Ai po ndihet mirë në skuadrën e Mallorcas, prandaj edhe dëshiron të jetë pjesë e këtij klubi deri në fund të karrierës. "E them gjithmonë se do të rri këtu sepse jam përshtatur këtu. Jam në shtëpi, tifozët më duan, edhe unë i dua ata dhe jam në një ishull, që është një parajsë. Shpresoj të mund të rri këtu deri në fund të karrierës, jo veç deri në fund të kontratës sime", ka thënë Muriqi. Mallorca ia vendosi klauzolën e shkëputjes së kontratës në vlerë prej 40 milionë eurosh.

#### Krasniqi: Jam i fokusuar te Cluji, krenar me interesimin e Lazios

Ermal Krasniqi ka thënë se është i fokusuar te skuadra e Clujit. Ai në një deklaratë për "ProSport" ka thënë se ndihet i nderuar me interesimin e trajnerit të Lazios. "Tani jam i fokusuar në Cluj dhe do të jap gjithçka. Por, nëse vijnë oferta, jam i lumtur t'i marr ato. Ndihej i nderuar të di se ka klube të mëdha që më ndjekin. Kjo më bën të punoj edhe më shumë për ëndrrën time. Është mirë që Sarri më vlerësoi. Jam i nderuar. Mendoj se mund të luaj në çdo kampionat evropian", ka thënë Krasniqi. 24-vjeçari ishte transferuar te Cluji nga Ballkani dhe ka shënuar pesë gola dhe ka dhuruar dy asistime në 19 ndeshje. Ai ka kontratë me skuadrën rumune deri në verën e vitit 2026.

#### Rashica qëndron në Galatasaray

Kontrata e futbollistit të Kosovës, Milot Rashica, me Galatasaray, skadon në fund të muajit qershor. Mediet në Turqi e bëjnë të sigurt që Rashica do të vazhdojë me Galatasaray edhe për disa vjet të tjera. Ai është i huazuar nga Norwich City, skuadër kjo që shpreson shitjen e kosovarit për 11 milionë euro dhe t'i mbushë arkat e klubit për shkak të problemeve financiare. Rashica kërkohet edhe nga Burnley dhe Fenerbahçe.

## Trajneri i Baselit mbron Xhakën: Ai është shembull, të gjithë njerëzit bëjnë gabime

Bazel, 11 maj - Trajneri i Baselit, Heiko Vogel, i ka dalë në mbështetje mesfushorit shqiptar Taulant Xhakës pasi ky i fundit po përballlet me kritika të mëdha në kohën kur bëri një veprim jospportiv gjatë derbit zviceran kundër Zurichut. Xhaka goditi

me kokë në gjoks kundërshtarit e tij të Zurich, Nicola Katiniq, goditje e cila u krahasua me atë të famshmen e Zidanes në Botërorin e vitit 2006 kundër Italisë në finale. "Xhaka është një shembull i mirë, pasi përpiqet t'i drejtojë dhe menaxhojë shokët e

skuadrës në fushën e blertë, por edhe jashtë saj. Ai është një lojtar emocional dhe është e pafalshme ajo që e bëri. Ai e di këtë, por është njeri dhe të gjithë bëjnë gabime", ka thënë trajneri i Baselit, Heiko Vogel, njofton "Blick". 32-vjeçari u dënua me

tetë ndeshje moslojë nga Federata e Futbollit e Zvicrës për shkak të atij veprimi. Xhaka është pjesë e ekipit të parë të Baselit që nga viti 2013, ndërsa edhe më parë ishte pjesë e grupmoshave të reja të gjigantit zviceran.



## Inzaghi: Ishte ndeshje e shkëlqyer. Pioli: Besojmë në përmbysjen e rezultatit

MILANO, 11 MAJ - Interi ka bërë një paraqitje të mirë në ndeshjen e parë të gjysmëfinale kundër Milanit, duke fituar me rezultat 0-2. Trajneri Simone Inzaghi është shprehur i kënaqur me fitoren që e afron shumë afër kalimit në finalen e madhe. Ai ka thënë se Interi ka mundur të shënojë më shumë se dy gola në këtë ndeshje. "Kemi pasur një pjesë të parë të jashtëzakonshme. Jam shumë i kënaqur. Natyrisht që mund të kishim shënuar edhe më shumë se dy gola, por ishte një ndeshje e shkëlqyer. Ne e dimë se jemi përpara. Por tani është ndeshja e dytë. Do të luajmë në shtëpi dhe do të kemi tifozët tanë dhe do të bëjmë një përpjekje për një ëndërr të madhe. Djemtë mbuluan çdo centimetër. Ata që hynë dhanë përgjigje të shkëlqyera. Kështu realizohen paraqitje të shkëlqyera. Për 72 orë kemi një ndeshje shumë të rëndësishme kundër Sassuolos dhe do të duhet të jemi të mirë në rikuperimin fizik dhe psikologjik pasi kemi shpenzuar shumë", ka deklaruar Inzaghi.

"Mkhitaryan dhe Dzeko? Ata patën një lojë të mrekullueshme. Ata janë të shkëlqyer ashtu si të gjithë të tjerët, bashkë me ata në bankinë që dëshironin të hynin. Një trajner duhet të bëjë shumë për vendimet.



Çdo ndeshje ka nga ata që presin të luajnë dhe ndoshta nuk janë të lumtur që nuk aktivizohen, por për mua e rëndësishme është që të gjithë kanë një zemër dhe një dëshirë të madhe për të bërë mirë për këtë fanellë", ka shtuar trajneri i Interit.

Ndërsa trajneri i AC Milan, Stefano Pioli, ka thënë se Interi luajti më mirë në ndeshjen e parë gjysmëfinale të Ligës së Kampioneve. Tekniku i kuqezinjve beson se me rikthimin e Leaos, Milani do të jetë më i fortë dhe mund ta përmbysë rezultatit (0-2). "Interi luajti më mirë se ne në

pjesën e parë dhe shënoi dy gola. Deri në minutën e shtatë zikaltrit nuk u futën asnjëherë në zonën tonë. Ne luajmë më mirë në pjesën e dytë, por nuk arritëm të shënonim. Kjo është diferenca në këto nivele. Më vjen keq! Dëshironim një tjetër paraqitje, një tjetër rezultat, por në sfidën e kthimit duhet të besojmë pasi episodet mund ta ndryshojnë ndeshjen. Leao? Ne e dimë rëndësinë e tij. Sot nuk ishte në kushtet e duhura. Pas gjashtë ditësh shpresojmë ta kemi në dispozicion. Shpresat janë se mund të jetë", ka thënë Pioli.

## Golden State dominon ndaj Lakers, New Yorku rihap garën me Miamin

NYU-JORK, 11 MAJ - New York rihap betejën për një vend në finalen "play-off" në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 112-103 ndaj Miamit. Një ndeshje e mirë për vendasit, ku u dallua Brunsoni me 38 pikë, mbështetur edhe nga



### Konferenca e Lindjes, "Play-off" - Gjysmëfinale

Boston - Philadelphia (2-3)  
New York - Miami 112-103 (2-3)

### Konferenca e Perëndimit, "Play-off" - Gjysmëfinale

Denver - Phoenix (3-2)  
Golden State - Lakers 121-106 (2-3)

Barrett me 26 pikë e Randle me 24 pikë. Për Miamin, dyshja Butler-Adebayo realizoi 37 pikë së bashku, pak për ta synuar fitoren. Po 3-2 udhëheq serinë e ndeshjeve

gjysmëfinale edhe skuadra e lakersave në Perëndim, që u mund me shifrat 121-106 nga kampionët e Golden State. Në fushën e saj, skuadra e Warriorsit nuk gaboi,

duke dominuar e fituar falë 27 pikëve të Curryt dhe 25 të Wigginsit. Për lakersat, Jamesi realizoi 25 pikë e Davisi 23, por që mbetën për statistikë.

### SHKURT

#### Kumbulla: Rikthehem më i fortë. Faleminderit për mbështetjen!

Marash Kumbulla para disa ditësh është lënduar në ndeshjen me Milanin, duke bërë kështu që mbrojtësi shqiptar të jetë jashtë fushave për disa muaj. Mbrojtësi kuqezi iu nënshtrua një ndërhyrje kirurgjikale e cila shkoi mirë. Ai në rrjetet sociale ka shkruar se do të rikthehet më i fortë se kurrë. "Ky operacion ishte hapi im i parë për rikthimin në fushë. Shkoi në mënyrën më të mirë dhe për këtë dua të falënderoj stafin mjekësor që më ka ndihmuar. Tani do të më duhet të pushoj fizikisht, por në kokën time jam gati të bëj gjithçka që duhet për të dhënë sërish 100 % për ngjyrat që unë mbroj. Faleminderit sërish të gjithëve për dashurinë dhe mbështetjen që më keni dhënë! Është një ndihmë e madhe. Forca, Roma!", ka thënë Kumbulla.

#### Reali, përveç Bellinghamit, e dëshiron edhe Mbappen

Real Madridi është shumë pranë pajtimit me mesfushorin Jude Bellingham nga Borussia Dortmundit për të cilin mungon vetëm firma. Skuadra madriline nuk do të ndalet me kaq, pasi do të tentojë edhe afrimin e Kylian Mbappes. Sipas "The Telegraph", skuadra madriline është duke punuar në fshehtësi për t'i siguruar shërbimet e sulmuesit 24-vjeçar, për të cilin është gati të thyejë çdo rekord transferimi. Mediet sqarojnë se Reali është gati të paguajë 224 milionë euro për Mbappen, dy më shumë se rekordi i 222 milionëve që PSG-ja pagoi për Neymarin. Kontrata e Mbappes me PSG-së skadon në verën e vitit 2025, por kjo nuk e pengon sulmuesin as Realin ta synojnë këtë transferim. Sulmuesi disa herë ka shprehur dëshirën të luajë në një ekip ku mund të fitojë në Evropë, gjë që nuk e ka arritur me parisienët.

#### Federeri: E rëndë për tenisn nëse Nadali nuk do të luante në Roland Garros

Rafael Nadal nuk po kalon një moment të mirë. Fituesi i 22 grand slameve nuk luan që prej Australian Open dhe nuk ka zhvilluar asnjë ndeshje në fushat me dhe, sipërfaqen e tij të pëlqyer. Kjo situatë ka shqetësuar edhe rivalin e mikun e tij Roger Federer, që ka rrefyer ndjesitë e tij. "Do të ishte e rëndë për tenisn nëse Rafael nuk do të luante në Roland Garros. Unë shpresoj që të luajë. Kam parë që është tërhequr nga të gjithë turnetë, ndaj i uroj më të mirën. Kjo vlen edhe për Djokoviqin që ka luajtur pak dhe shpresoj të jenë në formë në Paris. Ashtu sikurse edhe të rinjtë", ka thënë Federeri. Nadali po kalon të njëjtën fazë si Federeri dy vjet më parë, kur luante me pikatore për shkak të dëmtimeve e moshës dhe më pas vendosi të tërhiqej. "Është Rafaeli ai që e di më mirë se kushdo gjendjen e tij dhe e kuptoj se nuk është e lehtë për të. Uroj që kjo periudhë pushimi ta karikojë për Roland Garrosin", ka shtuar Federeri.

#### Oferta 'faraonike' nga Arabia për Llorisin

Portieri i Tottenham Hotspurit, Hugo Lloris, ka dhe një vit kontratë me "Spursin", por mund të largohet. Sipas raportimeve nga mediet britanike, francezi ka marrë ofertë fitimprurëse nga Arabia Saudite, e cila do ta trefishonte pagën e tij aktuale. 36-vjeçari ka oferta të shumta, por ende nuk është marrë një vendim, pasi ai pret të flasë me presidentin Daniel Levy për projektet e ardhshme të klubit. Lloris luan në Londër prej vitit 2012 duke qenë lojtari më i rëndësishëm në skuadër. Me kombëtaren e Francës arriti të shpallej kampion bote në Rusi 2018, por edhe fitues i Ligës së Kombeve në vitin 2021.

## Për Neymarin po kërkohet një klub i ri

Neymari nuk përjashton mundësinë e largimit nga PSG-ja. Sipas "RMC Sport", agjentët e Neymarit kanë filluar të kërkojnë një klub të ri për të. Çështja kryesore

janë kërkesat financiare të brazilianit dhe shumica e transferimit, ndaj një huazim është skenari më i mundshëm. Më herët ishte raportuar për interesimin për

sulmuesin nga Chelsea dhe Newcastle. Megjithatë, sipas publikimit, Neymar nuk ka marrë ndonjë ofertë specifike prej tyre. Vendimi i Neymarit shpjegohet me largimin e

mundshëm të Lionel Messit nga PSG-ja në fund të sezonit, si dhe me mosmarrëveshjet me drejtuesit e klubit. Përveç kësaj, Neymar është tronditur nga protesta që

ultrasit e klubit bënë pranë shtëpisë së tij. Kujtojmë se Neymar nuk ka luajtur për PSG-në që nga shkurti pas operacionit në ligamentet e kyçit të këmbës.



Kompania Rajonale e Ujësjetllësi  
"Mitrovica" SH.A.  
"Rr.Liqeni", p.n. 40000 Mitrovicë-Suhodoll

Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrje Publike (Ligji Nr. 03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit të KRU "Mitrovica" Sh.A., me seli në Mitrovicë-Suhodoll, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.04.2023, vendosi të shpall këtë:

### KONKURS PUBLIK

#### Titulli i punës : Zyrtar Kryesor Financiar

Vendi: Mitrovicë-Suhodoll

Ndërmarrja: Kompania Rajonale Ujësjetllësi, Mitrovica, Sh.A.

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Mitrovica" Sh. A. Mitrovicë

Mandati: 3 vite- me mundësi vazhdimi

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (k) dhe (l) dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë diplomë universitare Master të Fakultetit Ekonomik ose ekuivalente dhe përvojë të konsiderueshme nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit.
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë punë në menaxhim të dëshmuar në financa dhe/ose kontabilitetit;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional,
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi,
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime,
- Njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) do të jenë përparësi;

#### Funksioni dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtarit Kryesor Financiar të përcaktuara me Statutin e kompanisë:

Zyrtari Kryesor Financiar i Shoqërisë ("ZKF") do të menaxhoj, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE, çështjet financiare të Shoqërisë, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Këshilli i Drejtorëve- do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për Shoqërinë, dhe do të jetë përgjegjës që:

Të mirëmbajë llogaritë e Shoqërisë të azhuruara dhe të sakta;

Të themeloj dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme, dhe pasuritë themelore. Të monitoroj llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale. Të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e Shoqërisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;

Të përgatisë të dhënet e Shoqërisë për auditim në fund të vitit;

Të rishikoj, të arrij marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikat e sigurimit;

Të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve, si dhe të bëj blerje me KE dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të Shoqërisë;

Menaxhoj thesarin e Shoqërisë;

Të vendos dhe përgatitë buxhetet; dhe

Çfarëdo tjetër detyre e përcaktuar nga ana e KE.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e ZKF-së janë:

- Përgjigjet për të gjitha veprimet financiare të kompanisë në regjionin që e mbulon kompania.
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me: Bordin e Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit, Kryeshefit Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Drejtorin Teknik dhe Menaxherët e Departamenteve,
- Ka për detyrë të nxjerr dhe planifikoj buxhetin, të vëzhgojë mospërputhjet. Të përcjellë regjistrimin në kontabilitet, të japë këshilla të gjithë personelit të sektorëve për veprime efektive. Të vëzhgojë-përcjell qarkullimin e parasë së gatshme dhe transaksionet bankare,
- Përmes Menaxherit Ekzekutiv dhe personelit tjetër, të udhëheqë me ndërmarrjen përpara palëve të interesit (Bordi i Drejtorëve-Aksionari, Komuna, Donatorët). Të sigurojë llogari sipas nevojës që kërkohen për raportimin e ndërmarrjes,
- Përmes personelit nënrenditës, posaçërisht menaxherit ekzekutiv të shitjes, dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxherin ekzekutiv të shërbimit të konsumatorëve, të udhëheqë dhe kontrollojë të hyrat nga: Faturimi dhe inkasimi; mirëmbajtjen e të dhënave të konsumatorëve,

- Të këshillojë përmes Kryeshefit Ekzekutiv në Bordin e Drejtorëve, lidhur me progresin financiar të ndërmarrjes, planet e tanishme të biznesit dhe planet periodike dhe afat gjate të shpenzimeve dhe aktiviteteve, fluksin e të hyrave dhe shpenzimeve,
- ZKF-zotëron planin e aktivitetit të Kompanisë të specifikuar në çdo Plan të Biznesit,
- Kërkon, propozon, gjen dhe zbaton metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar metodat e punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Siguron se i gjithë personeli është i informuar me synimet dhe misionin e përbashkët të departamenteve, përkatësisht tërësisë së kompanisë,
- Udhëheqë personelin nënrenditës për të siguruar shërbime efektive,
- Vazhdimisht kërkon metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar qasjen ndaj punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Për punën që kryen i përgjigjet Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

**Paga:** Në pajtim me „Rregulloren për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM-së „ të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

#### Procedura e aplikimit:

Aplikacioni duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diplomat nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmitë e eksperiencës në punë / referencat (duke pasur të shënuar email-adresat dhe numrat kontaktues),
- Certifikatat (nëse posedon) lidhur me njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

Aplikacioni dhe Deklarata nën Betim mund të merren në ueb-faqen e Kompanisë në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>. Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të skanuara ose në formatin .pdf në email adresën: [rekrutimi@kru-mitrovica.com](mailto:rekrutimi@kru-mitrovica.com).

Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll.



### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "SAM TERM GROUP" SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër UNIK: 811920877 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SAM TERM GROUP" D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811920877 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "SAM TERM GROUP" L.L.C. with headquarters in Gjakova, has come to the decision to quit its business: 811920877 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Kompanija Regionalnog Vodovoda  
"Mitrovica" D.O.,  
"Ul."Jezero", b.b. 40000 Mitrovica-Suvi Do

U skladu sa funkcijama i ovlaštenjima prdviđenim Članom 21 u vezi sa članom 17 Zakona o Javnim Preduzećima (Zakon Br. 03/L-087), izmenjen i dopunjen Zakonom Br.04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009) za Zakona o Javnim Preduzećima, Upravni Odbor i Komisije za Reviziju KRV "Mitrovica" D.O., sa sedištem u Mitrovici-Suvi Do, na sednici održanoj dana 27.04.2023 godine, odlučio da raspiše ovaj:

### JAVNI KNKURS

#### Radno Mesto : Glavni Finacijski Zvaničnik

Mesto: Mitrovica-Suvi Do

Preduzeće: Kompanija Regionalni Vodovod., Mitrovica., D.D.

On Odgovara: Upravnom Odboru i Izvršnom Direktor KRV „Mitrovica“ D.D. Mitrovica.

Mandat: 3 godine – sa mogućnošću produženja

#### Uslovi i zahtevane kvalifikacije:

Upravni Odbor želi da se obezbedi da svi potencijalni kandidati budu lica sa poznatim integritetom koji ispunjavaju uslove kvalifikacija prema članu 17.1., ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2. tačka (d), (f), (k) i (l) i imaku potrebno stručno iskustvo i zahtevano školovanje za navedenu poziciju.

#### Osim ovih opštih uslova, kandidati treba da ispunjavaju i ove posebne uslove:

- Da ima Univerzitetsku diplomu Master Ekonomskog Fakulteta ili ekuivalent i značajno iskustvo u oblasti i/ili računovodstva.
- Diplome od stranih univerziteta teba da budu nostifikovane od strane Ministarstva prosvete, Nauke i Tehnologije;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u dokaznom menadžmentu i/ili računovodstvu;
- Da ima visok moralni i profesionalni integritet,
- Da ima dokazne sposobnosto upravljanja,
- Poznavanje stranih jezika je prednost,
- Da ne bude osuđen ili pod istragom,
- Znanje u tumačenju Međunarodnih Računovodstveni Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finacijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovoda (MFR) će biti prioritet;

#### Funkcionisanje i glavne odgovornosti Glavnog Finacijskog Zvaničnika određene Statutom Kompanije:

Glavni Finacijski Zvaničnik Društva (GFZ) će upravljati pod upravom i nadzorom IO, finacijske poslove društva, podležu graničenjima koja nameće Upravni odbor – imat će autoritet veze svih finacijskih ugovora za Društvo, i bit će odgovoran da:

Da održava račune Kompanije ažurnim i tačnim.

Da uspostavi i upravlja svim internim finansijskim kontrolama, uključujući nabavke, gotovinskog novca i osnovna sredstva. Da prai dugovanja i koordinira plaćanje računha i posebne kupovine. Da pregleda troškove zaposlenih kako bi se osigurala uskladenost sa politikama kompanije i njihovim budetom pre njihovih isplata.

Da pripremi podatke Kompanije za reviziju na kraju godine;

Da preispita postizanje sporazuma za nabavku i održavanje shih poslova vezanih sa politikama obezbedenja;

Da koordinira ostale funkcije poslovanja, kao što su izdavanje objekata i opreme pod zakum, kao i da vrši kupovinu za EK i kancelarijom ili funkcijom nabavke kompanije.

Da menadžita trezorom Kompanije;

Da odlučuje i pripremi budete, i

I bilo koji drugi zadatak koji odredi EK.

#### Zadaci i odgovornosti GFZ su;

- Odgovara za sve finacijske postuake kompanije u rgiji koju pokrova kompania.
- Obavezuje se za usku saradnju sa: Upravni Odbor i Komisije za Reviziju, Izvršnim Direktorom, Komercijalnim Direktorom, Tehničkim Direktorom i sa rukovodiocima odeljenja.
- ma za zadatak da izradi i planira budžet, da prato neslaganja . Da prati registraciju u računovodstvu, da daje savete čitavom osoblju sektora za efektivne postuake. Da prati promet gotovog noca i bankarskih transakcija.
- Preko Izvršnog Direktora o ostalog osoblja, da rukovodi sa preduzećem pred stranama interesa (Bord Direktora-Akcionari, Opština, Donatori). Da obezbedi rakun po potrebi koji se zahtevaju za izveštavanje preduzeća.
- Preko podređenog osoblja, posebno izvršnog direktora prodaje, i u uskoj saradnji sa izvršnim direktorom usluga potrošača, da rukovodi i kontroliše prihode od: Fakturisanja i inkasiranja, odražavanje podataka potrošača.
- Da savetuje preko Glavnog Izvršnog Direktora u Upravnom Odboru, u vezi sa finacijskim progresom preduzeća, sadašnje planove poslovanja i periodične i dugoročne planove trokova i aktivnosti, tok prihoda i rashoda.
- GFZ-poseduje poslovni plan Kompanije specifikovane u vaki Plan

- Zahteva, predlaže, namazi i sprovodi metode i načine za promenu i popravku metoda rada sa namerom poboljšanja usluga potrošača.
- Obezbeduje da svo osoblje bude informisano sa namerama i zajedničkom misijom odelenj, odnosno celine kompanije,
- Vodi podređeno osoblje kako bi osigurali efikasne usluge,
- Stalno traži metode i načine da prometi i popravi pristup prema radu sa namerom popravljnja usluga potrošača.,
- Za obavljene posao odgovara Upravnom Odboru i Glavnom izvršnom Direktor.

**Plata:** U skladu sa "Pravilnikom o raspodeli ličnih primarja KRVM" usvojeno od strane Upravnog Odbora. .

#### Procedura aplikacije:

Aplikaciji treba priložiti i sledeća dokumenta:

- CV-ja (Biografija),
- Kopija lisne karte,
- Motivaciono pismo,
- Izjava pod zakletvom,
- Univerzitetska Diploma (notarizovana kopija, dok diplome sa univerziteta van zemlje treba da budu nostrifikovane),
- Dokaz od i nadležnog suda da nije pod istragom, ne starija od 6 meseci,
- Dokazi o stručnoj spremi,
- Dokazi o radnom iskustvu/ reference (navodeći imejl adrese i kontakt brojeve)
- Sertifikati (ukoliko ih poseduje) u vezi sa Znanjem u tumačenju Međunarodnih Računovodstvenih Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finacijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovoda (MFR) će biti prioritet;

Aplikacije mogu da se uzmu u direkciji Kompanije (ili veb-stranici Kompanije) na adresi : <http://www.kru-mitrovica.com/kerko-me-shume/konkurset/>. Aplikacija i prateća dokumenta treba da se predaju skenirano ili u .pdf formatu na mejl adresu: [rekutimi@kru-mitrovica.com](mailto:rekutimi@kru-mitrovica.com)

Konkurs će biti overen 30 dana od dana objavljivanja u sredstvima informisanja. Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju..

KRV"Mitrovica"D.D. Mitrovic-Suvi Do.



### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Afrim Byci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Mazllom Këpuska", Gjakovë.

- Xhevat Morina shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Nihat Skeja shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Liridona Paluca shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren.

- Ahmet Musaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.

- Mert Drini shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHFMU "Mati Logoreci" Prizren.

- Petrit Rizvanolli shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së IV të shkollë së mesme ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Elmenda Lushaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10, 11, 12 të gjimnazit "Hajdar Dushi, Gjakovë.

- Saranda Rama shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M. të Mjekësisë, "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Arbëresha Muçaj shpall të pavlefshme dëftesat e klasëve: I, II, III, IV si dhe diplomën e lëshuar nga SH.M e Mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD  
**PASHTETË PULE**

gluten  
free



**cilësi e garantuar**

pa konservues